

Kopje e vërtetë me origjinalin
Dr. A. Muharemetaj
Sek. Përngj. A. Bylykbashi

27

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: "Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Qamil Guranjaku".

Kjo Kontratë është lidhur më datë **29.07.2016**, midis Bashkise Elbasan tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe operatorit ekonomik: bashkimit të shoqerive, "Ergi" sh.p.k & "Leon Konstruksion" sh.p.k., sipas akt- marreveshjes për bashkimin e perkohshem të shoqerive date 01.07.2016 dhe Prokures se Posaçme Nr.682 rep.374 kol. date 01.07.2016 të Dhomes se Notereve-Durres. i percaktuar me poshte si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar prokurimit nr. _____

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **04.07.2016** bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitura përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontratë. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **65.448.856** (gjashtëdhjete epesemilion e katerqind e dyzet e tetemije e teteqind e pesedhjete e gjashte) **lekë** (me tvsh) për realizimin e Punëve:

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **6.544.885** (gjashtëmilion e peseqind e dyzet e katermije e teteqind e tetedhjete e pese) **leke** dhe në formën e Depozites Bankare/ Certifikates se Garancise, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.



5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 29.07.2016 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR
BASHKIA ELBASAN
KRYETARI

QAZIM SEJDINI
Me Urdher dhe Porosi
Zv/ KRYETARI
ERVIN SARAÇI



PER KONTRAKTUESIN
"ERGI" sh.p.k.
ADMINISTRATORI



FLORENC SHARKA



Kopje e njëjtë me origjinalin

Dr. A. Muhametaj

Sek. Pëngj.

A. Bylykbashi